

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me kohë të plotë në pozicionin “Specialist i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ALUMNI dhe Karrierës”, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike duhet të plotësoj kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar “Master Profesional”, “Master i Shkencave” ose diplomë të integruar në një nga universitet brenda ose jashtë vendit.
2. Të njohë Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe të ketë njohuri mbi proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në kuadër të akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit.
3. Të ketë njohuri mbi programet e studimit që ofron Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, kriteret e pranimi dhe politikat institucionale, si dhe të jetë në gjendje të informojë dhe orientojë nxënësit e arsimit të mesëm mbi këto programe.
4. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi, si dhe të jetë në gjendje të këshillojë studentët e diplomuar në Ciklin e Parë për mundësitë e vazhdimi të studimeve në programe të Ciklit të Dytë në FIMIF, në UPT apo në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.
5. Të zotërojë një gjuhë të huaj të Bashkimit Evropian, në nivel të mjaftueshëm për komunikim profesional.
6. Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve bazë kompjuterike (paketa Office dhe sisteme të menaxhimit të të dhënave).

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **18.03.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.